



Projekt I finansuar nga
Bashkimi Evropian

AD



„МЛАДИНСКО УЧЕСТВО ЗА СИЛЕН И
ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ НА ЗАЕДНИЦАТА”

Raport nga hulumtimi

Përvojat dhe aktivitetet e të rinjve nga Pollogu dhe niveli i pjesëmarrjes në bashkësi



СОС ДЕТСКО
СЕЛО



Përvojat dhe aktivitetet e
të rinjve nga Pollogu
dhe niveli i pjesëmarrjes
në bashkësi

Raport nga hulumtimi

**Botues:**

Asociacioni për iniciativa demokratike (ADI)

www.adi.org.mk

Redaktor:

Lulzim Haziri

Autorë:

Natasha Amdiju

Ana Stanoevska

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Muamet Sallmani

Dizajn dhe printim:

Kontura

Ky publikim është pjesë e projektit "Gjenerata për ndryshim - liderët e rinj nga Pollogu" i cili financohet nga programi i granteve të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fortë dhe të qëndrueshëm të komunitetit" financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga Koalicioni i Organizatave rinore SEGA. Përmbajtja e këtij publikimi është tërësisht përgjegjësi e Asociacionit për Iniciativa Demokratike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian





Përmbajtja

Prezantimi	8
Rezimeja ekzekutive	11
Metodologjia	12
Gjetjet nga pyetësi i realizuar	14
Përfundime dhe rekomandime	31
Shtojcë	34
Bibliografia	37

Grafiku 1 Struktura moshës e të rinjve të anketuar	14
Grafiku 2 Gjinia e të anketuarve.....	15
Grafiku 3 Të anketuarit sipas komunave	15
Grafiku 4 Të anketuarit sipas përkatësisë etnike.....	16
Grafiku 5 Paraqitja e shkallës së aktivitetit të të anketuarve në bashkësitë e tyre lokale	16
Grafiku 6 "Çfarë është për ju pjesëmarrja aktive në komunitet?".....	17
Grafiku 7 "A mendoni se të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre?"	18
Grafiku 8 Paraqitja e arsyeve se sa shpesh të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre	18
Grafiku 9 Niveli i informacionit për mundësitë e të bërit punë vullnetare?	19
Grafiku 10 Paraqitja e fushave për mundësitë e vullnetarizmit për të rinjtë	20
Grafiku 11 Paraqitja në një shkallë nga 1 deri në 5 se sa e hapur është pushteti lokal ndaj nismave dhe propozimeve të të rinjve në komunë	21
Grafiku 12 Paraqitja se sa e hapur është pushteti lokal ndaj nismave dhe propozimeve	22
Grafiku 13 Tregon në një shkallë nga 1 deri në 5 se sa pushteti lokal i mbështet idetë e të rinjve në komunë.	23
Grafiku 14 Tregon se sa pushtetet lokale i mbështesin idetë e të rinjve sipas komunave	24
Grafiku 15 Paraqitja e problemit më të vogël dhe më të madh të të rinjve në komunat e tyre.	25
Grafiku 16 Çfarë konsiderojnë të rinjtë në komunën e Tetovës si problemin më të vogël dhe më të madh.....	27





Grafiku 17 Çfarë konsiderojnë të rinjtë në komunën e Gostivarit si problemin më të vogël dhe më të madh..... 28

Grafiku 18 Çfarë konsiderojnë të rinjtë në komunën e Vrapçishtit si problemin më të vogël dhe më të madh..... 29





**“RINIA ËSHTË
PRIJËS I
PROSPERITETIT”**
Benjamin Disraeli



Parathënie

Raporti nga një hulumtim i bërë **për përvojën dhe aktivitetet në të cilat janë të angazhuar të rinjtë nga Pollogu dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në komunitet**, analizon perceptimet e të rinjve për pjesëmarrjen qytetare, aktivitetet dhe angazhimet në atë fushë, si dhe arsyet dhe pengesat e mundshme për mosveprimin e tyre. Raporti gjithashtu identifikon problemet në komuna që prekin drejtpërdrejt të rinjtë.

Përpilimi i këtij raporti është rezultat i përpjekjeve të Asociacionit për Iniciativa Demokratike (ADI) për të siguruar që pjesëmarrja dhe problemet e të rinjve të merren parasysh nga publiku dhe vendimmarrësit. **Ky raport** është pjesë e projektit "**Gjenerata për Ndryshim - Liderë të Rinj nga Pollogu**", i implementuar nga Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI). Projekti financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, përmes programit të granteve të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm të komunitetit", zbatuar nga Koalicioni i organizatave rinore SEGA.

Me hulumtimin, përveç mbledhjes së të dhënave dhe fakteve relevante për pozitën, qëndrimet dhe problemet e të rinjve sot, duam të inkurajojmë aktorët shoqërorë (institucionet, partitë politike, organizatat rinore dhe mediat) që të merret parasysh pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut si grup shoqëror me interesat dhe nevojat e tyre specifike.

Të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç, të cilët janë target grupi i këtij hulumtimi, janë një kategori e qytetarëve që shteti rrallë i sheh të ndarë nga kategoritë e tjera të qytetarëve. Edhe kur bëhet fjalë për krijimin e politikave që synojnë të rinjtë, shteti shpesh merr një qasje të unifikuar, në vend që të vërë në perspektivë nevojat e të rinjve me prejardhje të ndryshme, si të rinjtë nga zonat rurale dhe qytetet e vogla, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë nga familjet me të ardhura të ulëta. Duke pasur parasysh këtë, është e lehtë të supozohet se të rinjtë, "masat" e të cilëve nuk janë politika dhe zgjidhje të miratuara, kanë më pak zgjedhje kur bëhet fjalë për mundësitë arsimore, mundësi të mëtejshme për zhvillim dhe përparim personal, mundësi për vetë-shprehje, si dhe pjesëmarrja në ngjarje kulturore.

Prandaj, rekomandimet në këtë analizë, të dedikuara për secilin palë të interesuar individualisht, synojnë të inkurajojnë ndërtimin e kushteve më të mira për pjesëmarrjen dhe mirëqenien e të rinjve. Pjesë e rekomandimeve kyçe, ato që i kushtohen periudhës së ardhshme janë: krijimi i mundësive, gjegjësisht masa aktive për punësimin e të rinjve pas përfundimit të shkollës, njohja e nevojës për arsimim të dual, ofrimi i mundësive për aftësim profesional të të rinjve sipas kërkesës së fuqisë punëtore, komunitat të inkurajojnë të rinjtë të bashkëpunojnë përmes mekanizmave dhe hapësirës për dialog, komunitat të ofrojnë mbështetje për aktivizmin rinor dhe



organizimin rinor dhe të forcojnë kapacitetet e të rinjve për avokim dhe politikëbërje. Në planin afatgjatë, fokusi duhet të jetë krijimi i një strategjie kombëtare rinore, ngritja e qendrave lokale rinore dhe përmirësimi afatgjatë i pozitës ekonomike të të rinjve.



Prezantimi

Të rinjtë përbëjnë afër një të katërtën e popullsisë së botës, por përfshirja e tyre në vendimmarrje dhe politikëbërje është e parëndësishme, gjë që vë në pikëpyetje cilësinë përfaqësuese të këtyre organeve. Në çdo shoqëri, të rinjtë janë forca lëvizëse e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Ata janë të përfshirë në mënyrë aktive në jetën e përgjithshme shoqërore, sjellin ndryshime, japin ide dhe përparojnë drejt një shoqërie më të mirë dhe më humane.

Të rinjtë në vendin tonë paraqesin margjinat e shoqërisë sonë. Edhe pse u bënë përpjekje për të miratuar strategji dhe plane, madje edhe një ligj për të rinjtë, fatkeqësisht të rinjtë ende mungojnë në proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar. Sipas legjislacionit kombëtar, termi "rini" në Maqedoninë e Veriut nënkupton çdo person nga moshën 15 deri në 29 vjeç.

Në vitin 2021, nga gjithsej popullata e re në Maqedoninë e Veriut (afërsisht 390,000 njerëz), rreth 130 mijë (ose 33,4%) ishin të punësuar dhe 50,000 njerëz ishin të papunë (12,9%). Rreth 210,000 të rinj ishin joaktivë, kryesisht për shkak të ndjekjes së mësimave (78.1% e të gjithë të rinjve joaktivë). Në të njëjtin vit, pothuajse 40% e të gjithë të rinjve të papunë kërkonin punë për më shumë se një vit. Shkalla e të rinjve jo të punësuar dhe të pa përfshirë në arsim apo trajnim ishte 24.2%, pothuajse dyfishi i normës mesatare të regjistruar në BE (13.7%).¹ Gjendja e vështirë e të rinjve është veçanërisht e rëndë në rajonet verilindore, Pollogsk dhe jugperëndimore të vendit, ku nivelet e papunësisë së të rinjve - dhe veçanërisht pjesa e papunësisë afatgjatë - janë më shumë se tre herë më të larta se mesatarja e regjistruar në rajonet juglindore dhe lindore.² Kostoja e papunësisë së të rinjve për individët dhe shoqërinë është e lartë. Për shoqërinë, shkalla e lartë e papunësisë zvogëlon kontributin e mundshëm të të rinjve në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

Arsyet për rritjen e shkallës së emigrimit të të rinjve nga Republika e Maqedonisë së Veriut janë pikërisht mungesa e politikave të krijuara si duhet për të rinjtë në fushën e arsimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale, si dhe funksionaliteti i ulët i institucioneve. Emigrimi, pakënaqësia, si dhe mungesa e komunikimit për përfshirjen aktive të të rinjve në proceset demokratike janë pjesë e faktorëve që ndikojnë në ngecjen e kapitalit social të të rinjve në vendin tonë gjatë dhjetë viteve të fundit.³ Mungesa e politikave, strategjive dhe dokumenteve moderne që do të përmirësojnë pozitën e të rinjve nëpërmjet përfshirjes së tyre efektive në vendimmarrje në procesin arsimor

¹ https://socioledijalog.mk/wp-content/uploads/2022/08/MKD_NEET-Mapping-and-Policy-Proposals.pdf

² ibid

³ ibid

në nivel lokal dhe kombëtar, është diçka që gjatë viteve ka qenë një sfidë për autoritetet arsimore, lokale dhe kombëtare.

Në Strategjinë Kombëtare për Rininë (2016-2025) theksohet se: “Rinia janë bartëse të ndryshimeve pozitive, si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në mbarë botën. Ato janë një burim për inovacion dhe forca lëvizëse e ardhshme e zhvillimit social dhe ekonomik. Të rinjtë sfidojnë normat dhe vlerat e vendosura dhe ndërtojnë themelet për të ardhmen e vendit tonë. Republika e Maqedonisë e respekton këtë rol të rëndësishëm të të rinjve. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që vazhdimisht dhe sistematikisht të investohet në zhvillimin e tyre, si dhe në vendosjen e mekanizmave për pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset shoqërore.”⁴

Ligji për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore e përkufizon termin "pjesëmarrje rinore" si një proces që u mundëson të rinjve të marrin pjesë dhe të marrin vendime të përbashkëta për politikat dhe programet që formësojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi jetën e të rinjve. Në kuadër të vetë ligjit, parashikohen mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel kombëtar, përkatësisht Asamblenë Kombëtare e Rinisë; dhe në nivel lokal, d.m.th. Këshillat Rinor Lokal. Për sa i përket zbatimit, Asambleja Kombëtare e Rinisë dhe rrjedhimisht Trupi Kombëtar Këshillimor për Politikat Rinore ende nuk janë themeluar dhe Këshillat Rinor Lokal ekzistojnë vetëm në 11 komuna (13.5% e numrit të përgjithshëm të komunave).⁵

Pjesëmarrja e të rinjve është pjesë e prioritetëve strategjike të Strategjisë Kombëtare për Rininë (2016-2025), megjithatë ajo nuk parashikon ndonjë dispozitë apo masë specifike që i referohet të rinjve që vijnë nga mjedise me më pak mundësi.

Mundësitë për të rinjtë në rajonin e Pollogut janë dukshëm më të vogla se të rinjtë në qytetin e Shkupit dhe rajonin e Shkupit. Të rinjtë nga komunitetet më të vogla janë ndër grupet më vulnerabël dhe më të përjashtuara në komunitet, veçanërisht në proceset vendimmarrëse që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Këtë e vërteton edhe studimi i fundit për trendet rinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku theksohet se të rinjtë nuk kanë përvojë të madhe në konsultim në proceset vendimmarrëse, si nga vetëqeverisja lokale ashtu edhe nga institucionet e tjera vendore. Të rinjtë besojnë se mënyra dhe motivimi më i mirë për t'u përfshirë në vendimmarrje në nivel lokal është përmes organizatave të shoqërisë civile, theksohet në studim.⁶

⁴ Национална стратегија за млади 2016-2017 г.

⁵ https://www.nms.org.mk/wp-content/uploads/2022/04/Monitoring-izvestaj_MKD-2.pdf

⁶ Детско село Северна Македонија, ПОЧЕТНА СТУДИЈА ЗА МЛАДИНСКИТЕ ТРЕНДОВИ ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, 2021

Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse është një mekanizëm i rëndësishëm për realizimin e qytetarisë aktive. Konsultimi me të rinjtë për çështje të ndryshme të interesit të tyre, nga planifikimi urban dhe menaxhimi i mjedisit të tyre, te çështjet e arsimit, punësimit, strehimit, siguron legjitimitetin e vendimeve dhe politikave të autoriteteve.

Ka filluar zhvillimi i Strategjisë së re Kombëtare për Rininë e Maqedonisë së Veriut dhe do të përfshijë periudhën 2023-2027. Strategjia e re duhet të përcaktojë synime të qarta, me një plan veprimi konkret dhe të zbatueshëm për shënjestrimin e problemeve më të mëdha të të rinjve, por duhet të tregojë edhe rëndësinë e planifikimit dhe zbatimit strategjik, veçanërisht për të rinjtë nga mjediset më pak të zhvilluara.

Raporti i hulumtimit të bërë për **përvojën dhe aktivitetet në të cilat janë të angazhuar të rinjtë nga Pollogu dhe shkallën e pjesëmarrjes së tyre në komunitet** është në kuadër të projektit **"Gjenerata për ndryshim - liderët e rinj nga Pollogu"**, të implementuar nga Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI). Projekti financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, përmes programit të granteve të projektit "Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm të komunitetit", zbatuar nga Koalicioni i organizatave rinore SEGA.


Rezimeja ekzekutive

Sipas të dhënave të përmbledhura nga pyetësi i anketës, vëmë re se nga 5 fushat e ofruara, të rinjtë rëndësinë më të madhe i kanë dhënë problemeve në fushën e punësimit dhe arsimit. Ky problem shkak-pasojë, i cili vazhdon prej kohësh në shoqëri, ka filluar të marrë një ritëm gjithnjë e më të madh.

Të rinjtë njohin problemet kryesore në mjedisin e tyre lokal dhe kanë vullnetin për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit lokal. Përveç punësimit dhe arsimit, të rinjtë nga Pollogu njohin infrastrukturën dhe mjedisin si problemet e radhës më dominuese.

Në pyetjen e hapur, ku të anketuarit mund të deklarojnë se cilat probleme të tjera i konsiderojnë relevante, **numri më i madh është shprehur se problemi që duhet trajtuar është edukimi dhe nevoja për edukim joformal më aktiv të të rinjve.**

Në vazhdim të tekstit përcjellni analizën e plotë.



Metodologjia

Procesi i hulumtimit të aktivizmit dhe nevojave të të rinjve nga rajoni i Pollogut u strukturua në atë mënyrë që të ofrojë udhëzime për rrjedhën e përgjithshme të aktiviteteve dhe angazhimin e të rinjve.

Janë organizuar intervista orientuese gojarisht (me 6-7 të rinj nga secila komunë) për të marrë gjetjet fillestare dhe për të krijuar instrumentin e kërkimit (pyetësin) në përputhje me rrethanat.

Qëllimi i organizimit të intervistave orientuese është mbledhja e të dhënave fillestare për përvojën dhe aktivitetet në të cilat janë të angazhuar të rinjtë nga Pollogu, si dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në komunitet. Intervistat orientuese u zhvilluan gjatë muajit Nëntor 2022.

Qëllimi i tyre ishte të ndihmonin në krijimin e versionit përfundimtar të instrumentit të anketimit, i cili përfshinte, por nuk kufizohej në, pyetjet e mëposhtme: arsimit; problemet specifike në komunitet; përfshirja në rrjetet formale dhe joformale, përfshirja e tërthortë dhe e drejtpërdrejtë në vendimmarrjen lokale; pyetje ekzistenciale; pavarësia etj. Hulumtimi është realizuar duke vendosur pyetësin në një platformë online, si mjeti më i shpejtë dhe më efikas për mbledhjen e të dhënave që do të analizojë situatën aktuale në lidhje me nevojat e të rinjve.

Përpara se të merrnin pjesë, të rinjtë u informuan për natyrën e hulumtimit dhe iu tha se pjesëmarrja e tyre ishte vullnetare. Të gjithë pjesëmarrësit u informuan për hulumtimin, qëllimet e tij dhe çfarë roli kanë ata në këtë proces. Atyre iu tha qartë se duke marrë pjesë nuk do të dëmtonin askënd, por nuk do të kishin as përfitime të menjëhershme personale. Atyre iu tha të jepnin pëlqimin verbal për të marrë pjesë në intervistë dhe u shpjeguan se mund të tërhiqeshin nga procesi në çdo kohë. Në këtë kontekst, të rinjtë u lejuan të anashkalonin pyetjet që nuk donin të përgjigjen.

Intervistat orientuese dhanë informacione të rëndësishme për jetën e të rinjve në komunat Vrapçisht, Gostivar dhe Tetovë, nevojat dhe problemet e tyre. Intervistat orientuese dhanë edhe udhëzime për përgatitjen e pyetësit për përvojën dhe aktivitetet në të cilat janë të angazhuar të rinjtë nga Pollogu dhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në komunitet.

Pyetësi u është shpërndarë të rinjve nga komuna Gostivar, Tetovë dhe Vrapçisht dhe ka përfshirë gjithsej 503 të rinj të moshës 15 deri në 29 vjeç.

Numri më i madh i të rinjve, të përfshirë nga hulumtimi, 38.6% janë të moshës 19-25 vjeç, ndërsa 34.6% janë të moshës deri në 18 vjeç. Struktura gjinore është mjaft e barabartë, 50.7% janë të anketuar meshkuj dhe 49.3% janë femra.

Më së shumti përgjigje në pyetësor kanë ardhur nga komuna e Gostivarit 43,9%, pastaj nga komuna e Tetovës 27,4% dhe nga komuna e Vrapçishtit 28,6%. Sipas strukturës etnike, 59% e të rinjve janë nga komuniteti etnik shqiptar, 25% janë nga komuniteti etnik maqedonas, 11% janë nga komuniteti etnik turk dhe 5% janë nga komuniteti etnik rom.

Hulumtimi u realizua duke vendosur pyetësorin në një platformë online, si mjete më i shpejtë dhe më efikas për mbledhjen e të dhënave që analizojnë situatën aktuale në lidhje me nevojat e të rinjve. Temat që u trajtuan në pyetjet janë arsimi; problemet specifike në komunitet; përfshirja në rrjetet formale dhe joformale, përfshirja e tërthortë dhe e drejtpërdrejtë në vendimmarrjen lokale; pyetje ekzistenciale.

Intervistat orientuese, krijimi i instrumentit dhe përpunimi i të dhënave në një raport përfundimtar u kryen nga dy ekspertë.


Pyetësi përbëhet nga gjithsej 13 pyetje. Në shumicën e pyetjeve jepen përgjigje alternative (duke shënuar shenjën "X" pranë përgjigjes së saktë), dy pyetje mund të rrethohen më shumë se përgjigjet e ofruara dhe katër pyetje janë të natyrës së hapur. Vetë pyetësi paraprihet nga informacione të përgjithshme në lidhje me të dhënat në lidhje me moshën, gjininë dhe komunën në të cilën jetojnë të anketuarit.

Për të plotësuar këtë pyetësor mjaftojnë 5 minuta.

Gjetjet nga pyetësi i realizuar

Ky raport i referohet aktivizmit dhe nevojave të të rinjve nga rajoni i Pollogut, i cili do të ofrojë udhëzime për rrjedhën e përgjithshme të aktiviteteve dhe angazhimin e të rinjve në këtë rajon.

Grupmosha e të rinjve të përfshirë në hulumtim, nga gjithsej 503 të anketuar, **34.6% (174) janë nën moshën 18 vjeç**. Numri më i madh i të rinjve të anketuar janë **të moshës 19-25 vjeç, pra 38.6% (194)**. **22.3% (112) janë të moshës 25-30 vjeç** dhe numri më i vogël i të anketuarve janë të moshës **30+, pra 4.8% (24)**.



Grafiku 1 Struktura moshës e të rinjve të anketuar

Sa i përket gjinisë së të rinjve të anketuar të përfshirë në hulumtimin për aktivizmin dhe nevojat e të rinjve nga rajoni i Pollogut, **50.7% (255) janë meshkuj** dhe **49.3% (249) janë femra**.


Пол/Gjinia:
503 responses



Grafiku 2 Gjinia e të anketuarve


Më së shumti të anketuar të rinj që iu përgjigjën pyetësorit ishin nga **komuna e Gostivarit 43,9%** (221), nga **komuna e Tetovës 27,4% (138)**, nga **komuna e Vrapçishtit 28,6% (144)** të rinj të anketuar, dhe vetëm **0,2% personi (1)** nga komuna e Bogovinës.

Општина/Комуна:
503 responses



Grafiku 3 Të anketuarit sipas komunave


Numri më i madh i të anketuarve të rinj janë të **përkatësisë etnike shqiptare 59% (295)**, etnisë **maqedonase 25% (123)**, etnisë **turke 11% (57)** të anketuar, etnisë **rome 5% (26)**, dhe vetëm një i pyetur nga përkatësia tjetër.



Grafiku 4 Të anketuarit sipas përkatësisë etnike

Të rinjtë e anketuar në pyetjen e parë nëse janë aktivë në bashkësinë e tyre lokale **49.3% (248) janë përgjigjur po, 41.6% (209) janë përgjigjur JO, vetëm 11.1% (56) e të anketuarve të rinj janë përgjigjur po NUK E DI.**

1. Дали сте активни во својата локална заедница? /A jeni aktiv në komunitetin tuaj lokal?
503 responses



Grafiku 5 Paraqitja e shkallës së aktivitetit të të anketuarve në bashkësitë e tyre lokale

Në pyetjen “Çfarë është për ju pjesëmarrja aktive në komunitet”, numri më i madh i të anketuarve, **39.4% (198)** e konsiderojnë atë angazhimin në një organizatë qytetare, dhe **31% (156)** besojnë se pjesëmarrja aktive në komunitet është të ngrenë alarmin për problemet në komunitetin e tyre (për shembull në komunë). **27% (136)** nga të anketuarit janë përgjigjur me **Nuk e di**. Vetëm **2% (10)** të anketuar janë përgjigjur me tjetër, me **0.2% (1)** të anketuar që janë përgjigjur se pjesëmarrja aktive në komunitet paraqet përfshirjen e individëve në jetën publike dhe çështjet që mund të bëhen në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, dmth. duke u angazhuar në OJQ, ata rrisin ndërgjegjësimin për problemet, ndihmojnë të tjerët dhe u mësojnë të rinjve shumë gjëra. **Një i anketuar (0.2%)** është përgjigjur se pjesëmarrja aktive në komunitet është përgjigjet nën a) dhe b), pra angazhimi në një organizatë qytetare dhe ngritja e alarmit për problemet në komunitet.

2. Што е за вас активно учество во заедницата? / Çfarë është për ju pjesëmarrja aktive në komunitet?

503 responses




Grafiku 6 "Çfarë është për ju pjesëmarrja aktive në komunitet?"

Në pyetjen “A mendoni se të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre lokale”, **53,1% (267)** janë përgjigjur me PO, **34,4% (173)** janë përgjigjur me JO, dhe vetëm **17,5% (88)** të anketuar janë përgjigjur me NUK DI.

3. Дали сметате дека младите волонтираат во нивните локални заедници? / A mendoni se të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre lokale?

503 responses




Grafiku 7 "A mendoni se të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre?"

Pyetja nr.4 është në lidhje me një pyetje të mëparshme për të gjithë ata të anketuar që janë përgjigjur me PO, por sipas numrit të përgjigjeve të marra në këtë pyetje, të gjithë 503 të anketuarit janë përgjigjur njësoj. Prej tyre, **30.2% (152) besojnë se të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre lokale vetëm kur ka ndonjë problem që i prek ata**, 17.9% (90) të anketuar besojnë se të rinjtë bëjnë punë vullnetare shpesh në komunitetet e tyre lokale, por nuk njohin shumë vullnetarë. Nga të anketuarit, 15.1% (76) janë përgjigjur se ata vetë bëjnë punë vullnetare. 14.5% (73) janë përgjigjur se marrin pjesë vetëm kur ftohen të marrin pjesë në aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile, madje 22.3% (112) janë përgjigjur me NUK E DI.

4. Ако одговоривте со ДА, колку често? Можете да изберете повеќе одговори. / Nëse jeni përgjigjur PO, sa shpesh? Ju mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje.

503 responses




Grafiku 8 Paraqitja e arsyeve se sa shpesh të rinjtë bëjnë punë vullnetare në komunitetet e tyre

Sa i përket pyetjes 5, cilat janë arsyet dhe pengesat për mosbërjen e punëve vullnetare, **numri më i madh i të anketuarve kanë theksuar se të rinjtë nuk janë të motivuar për të marrë pjesë në aktivitete**, nuk ka mjaft vende ku do të aplikonin për të bërë punë vullnetare, nuk janë mjaft të informuar dhe a nuk janë të vetëdijshëm për potencialin që posedojnë. Si pengesë përse të rinjtë nuk bëjnë punë vullnetare është theksuar **mungesa e motivimit financiar që do t'u jepej të rinjve**, madje edhe nëse do të mjaftonte për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit. Në disa raste, të anketuarit theksojnë se fatkeqësisht në disa situata ka keqpërdorim të vullnetarëve për qëllime politike dhe kjo është një nga pengesat dhe arsyet e treguara pse të rinjtë nuk janë të interesuar për vullnetarizëm.

Nga gjithsej 502 të anketuar, **52.9% (265) janë përgjigjur se është e lehtë të mësosh për mundësitë e vullnetarizmit** (përmes rrjeteve sociale, etj.), **13.4% (67) u përgjigjën se nuk mund të gjenin informacion për mundësinë të bëjnë punë vullnetare edhe pse ata pyeten**. **21% (105) nuk kanë kërkuar informacion për mundësinë të bëjnë punë vullnetare**, dhe **12% (60) të anketuar nuk dinë se ku të kërkojnë informacion për mundësinë e vullnetarizmit**. 0.4% (2) të anketuarve janë përgjigjur se informacioni për mundësinë e vullnetarizmit është për shkak të pasjes së miqve vullnetarë dhe/ose miqve aktivë në organizatat e shoqërisë civile. Vetëm 0.2% (1) të anketuar deklaruan se sa më shumë informacion rreth mundësive të vullnetarizmit, aq më mirë.

6. Дали имате информации за можности за волонтирање? / A keni informacion për mundësitë e vullnetarizmit?

501 responses



Grafiku 9 Niveli i informacionit për mundësitë e të bërit punë vullnetare?

Për sa i përket mundësive e të bërit punë vullnetare, **35.6% (179)** e të anketuarve do të donin të avokonin për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mjedisit, **35% (176)** përmirësimin e cilësisë së arsimit për të rinjtë, duke përfshirë arsimin joformal (trajnim etj.) arsimimi (trajnimi etj.), **11.3% (57)** dëshirojnë të përfaqësojnë të drejtat e njeriut (të drejtat e bashkësive etnike, personat me aftësi të kufizuara, barazia gjinore, etj.). Nga të anketuarit, **15.7% (79)** nuk e dinë se çfarë do të donin të përfaqësonin. Për opsionin tjetër janë përgjigjur **1.2% (6)** të anketuar. Me **0,8% (4)** janë përgjigjur se do të donin të përfaqësonin të gjitha përgjigjet e përmendura më parë, d.m.th. përmirësimi i cilësisë së jetës dhe mjedisit, përmirësimi i cilësisë së arsimit të të rinjve, duke përfshirë arsimin joformal (trajnime, etj.), arsimit (trajnime, etj.) dhe të drejtat e njeriut (të drejtat e bashkësive etnike, personat me aftësi të kufizuara, barazia gjinore, etj.). Një i anketuar është përgjigjur se do të donin të përfaqësonin arsimin dhe kulturën, pra arsim cilësor, drejtësi, mbrojtje të natyrës dhe të gjitha gjërat tjera për të mirën e shoqërisë.

7. Доколку имате можност за волонтирање, за што би сакале да застапувате? Можете да изберете повеќе одговори./ Nëse do të kishit mun...ni? Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje.
503 responses



Grafiku 10 Paraqitja e fushave për mundësitë e vullnetarizmit për të rinjtë


Të anketuarit në pyetjen numër 8, në të cilën të anketuarit kërkohet të citojnë shembuj të aktivizmit të tyre/të të tjerëve, numri më i madh është shprehur se janë **vullnetarë të organizatave komunale të Kryqit të Kuq të R. Maqedonia e Veriut**, përmes së cilës marrin pjesë në aktivitete të ndryshme dhe janë pjesë e aksioneve të ndryshme humanitare. Në të njëjtën kohë, shumë kanë deklaruar se kanë qenë pjesë e trajnimeve me temë, **edukimin e bashkëmoshatarëve, aktivitetin gjinor, aktivizmin rinor**. Nga përgjigjet e marra ka të anketuar që marrin pjesë në mënyrë aktive ose janë pjesë e **eko eventeve dhe aktiviteteve për ruajtjen e mjedisit**, qoftë si pjesë e eventeve shkollore apo si vullnetarë në organizata joqeveritare.

Në shkallën nga 1 deri në 5, sa e hapur është pushteti lokal ndaj nismave dhe propozimeve të të rinjve në komunë, **1 – Plotësisht e mbyllur, sipas 12,9% (65) të anketuarve, 2 – Pjesërisht e mbyllur 20,3% (102)**, me **3 – As i hapur as i mbyllur, janë përgjigjur 39.2% (197) e të anketuarve.**

Me 4 – E hapur mendojnë 29.6% (149), dhe vetëm 6.2% (31) mendojnë se vetëqeverisja lokale është shumë e hapur dhe gjithmonë dëgjon problemet dhe nevojat e tyre.

9. На скала од 1 до 5, колку локалната самоуправа е отворена за иницијативи и предлози од младите луѓе во Вашата општина? / Në një shkallë...e dhe propozimeve të të rinjve në komunën tuaj?

503 responses




Grafiku 11 Paraqitja në një shkallë nga 1 deri në 5 se sa e hapur është pushteti lokal ndaj nismave dhe propozimeve të të rinjve në komunë

Në shkallën nga 1 deri në 5, **sa e hapur është pushteti lokal në Tetovë** ndaj iniciativave dhe propozimeve të të rinjve, **në shkallën 1, 10% (14) mendojnë se është plotësisht e mbyllur, 22% (32) e te anketuarve mendojnë se është pjesërisht e hapur për iniciativa dhe propozime**, pra e shënojnë me hapin 2. **Një e treta e të rinjve, pra 31% (45), besojnë se pushteti lokal duhet të vendoset në hapin 3 - as nuk është i hapur dhe as i mbyllur për iniciativa dhe propozime.** Një përqindje e përafërt, **pra 33% (48) të rinj të anketuar konsiderojnë se pushteti lokal është në hapin 4, pra e hapur për propozime dhe iniciativa, dhe vetëm 4% (5) të rinjtë e kanë renditur me 5 – shumë e hapur, gjithmonë e dëgjuar. për problemet dhe nevojat tona.**

Në të njëjtën pyetje, **të rinjtë e intervistuar nga Gostivari, pushtetin lokal e mendojnë se duhet të jetë në hapin 1, pse është plotësisht e mbyllur për iniciativa dhe propozime 9% (21). 19% (44) mendojnë se është pjesërisht i mbyllur, përkatësisht në shkallën e 2.** Përqindja më e madhe e të anketuarve mendojnë se pushteti lokal nuk është as i hapur dhe as i mbyllur, gjegjësisht **36% (86).** Të rinjtë nga komuna e Gostivarit besojnë se pushteti lokal është e hapur për propozime dhe iniciativa dhe e rendit në shkallën 4. **Vetëm 4% (9) besojnë se pushteti lokal është shumë e hapur dhe dëgjon nevojat dhe problemet e tyre. .**

Në komunën e Bogovinës, **vetëm një i anketuar ka besuar se pushteti lokal është shumë i hapur ndaj propozimeve dhe iniciativave dhe i dëgjon nevojat e tyre.**


